

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

**PUNIME NDIHMËSE HEKURKTHIMI,
KARPENTERIE DHE BETONIMI**

Kodi: PK-B-10-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Ndërtim” , K-B-II-25, Niv II i KSHK-së:

1.NjN-02-II-0228-25 “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi”

Niveli II i KSHK¹, referuar nivelit të II të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

.....

1. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2. Korniza Europiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të II të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi” me kod 02-II-0228-25 do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhërit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE HEKURKTHIMI, KARPENTERIE DHE BETONIMI”

(PK-B-10-25)

I. Profili Profesional i punëtorit ndihmës në hekurkthim, karpenteri dhe betonim

a) Karakteristikat e punimeve ndihmëse në hekurkthim, karpenteri dhe betonim.

Punëtori ndihmës për punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar në kompani ndërtimi, që kryejnë punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori ndihmës në hekurkthim, karpenteri dhe betonim duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. Suksesi i punëtorit ndihmës të punimeve gipsi, patinime dhe lyerje është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale

Profesioni i punëtorit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve ndihmëse në hekurkthim, karpenteri dhe betonim. Me përmbushjen e të gjithave njësive të të nxëniet të standardit të kualifikimit “Ndërtim” Niveli i II i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e metejshme të KSHK-së. Ky kurs i përgatit kursantet me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale të përfshira në profesionin “Punëtor të ndërtimit të banesave” me kod 9313, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.”

Në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. kursantët do të jenë të aftë të:

- Organizojnë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- Ndihmojnë në kryerjen e punimeve parapërgatitore;
- Ndihmojnë në punimet e hekurit;
- Ndihmojnë në montimin e shufrave të hekurit;
- Ndihmojnë në punimet e betonimit;
- Ndihmojnë në (dizarmimin) heqjen e kallëpeve
- Zbatojnë standardet e profesionit, gjatë punimeve ndihmëse në punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi;
- Zbatojnë standardet e kodit të etikës në punë;
- Raportojnë për punën e kryer te eprorët, sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara.

- Respektojnë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje” duhet të jenë mbi **16 vjeç** dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi”

141 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi	MK-02-397-25	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e e punonjësit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. 2. Kursanti liston llojet e hekurave në elementet konstruktivë, betonet dhe kallëpet. 3. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Punime parapërgatitore në hekurkthim, karpenteri dhe betonim	MK-02-398-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e shufrave të hekurit. 2. Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e materialit mbushës dhe lidhës për përgatitjen e betonit. 3. Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e kallëpeve për elemente betonuar.
3	Punime ndihmëse në hekurkthim dhe betonim	MK-02-399-25	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës në hekurkthim dhe betonim. 2. Kursanti ndihmon në punimet e hekurit 3. Kursanti ndihmon në montimin e shufrave të hekurit 4. Kursanti ndihmon në punimet e betonimit

4	Punime ndihmëse në karpentieri	MK-02-400-25	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës në karpentieri 2. Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për elemente betonarme(plint, shtylla, mure) b/a. 3. Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a. 4. Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për shkallë b/a .
5	Punime dizarmimi në elementet konstruktive	MK-02-401-25	21 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen organizimin e punës në dizarmimin e elementeve konstruktive. 2. Kursanti ndihmon në dizarmimin e elementëve konstruktivë 3. Kursanti ndihmon në riparimet e mundshme për elementët b/a pas dizarmimit

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Punime ndihmëse hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi”

1.Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E NDIHMËSIT NË PUNIME HEKURKTHIMI, KARPENTERIE DHE BETONIMI	MK-02-397-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët të përshkruajnë veçoritë e punonjësit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi, të listojnë llojet e hekurave në elementet konstruktivë, betonet dhe kallëpet, si dhe të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e punonjësit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë detyrat, qëndrimet kryesore të punonjësit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi; - të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike; - të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës; - të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; - të shpjegojë rëndësinë e raportimit rregullisht tek eprori për detyrën e dhënë; - të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti liston llojet e hekurave në elementet konstruktivë, betonet dhe kallëpet. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të listojë llojet e hekurave për elementet konstruktivë;	

- të listojë llojet e lidhjeve të hekurave;
- të listojë llojet e betoneve sipas elementeve betonarme;
- të listojë llojet e betoneve sipas përdorimit dhe markës;
- të listojë llojet e kallëpeve sipas formës dhe materialit;
- të listojë llojet e kallëpeve sipas materialit;
- të rendisë llojet të materialit mbushës, sipas përbërësve të betonit;
- të rendisë llojet të materialit lidhës, sipas përdorimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë pajisjet mbrojtëse (PMI) në vendin e punës;
- të përshkruajë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullores së brendshme, si dhe sinjalistikën e kantierit të ndërtimit;
- të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të përshkruajë procedurën e evakuimit në raste emergjente;
- të përshkruajë rregullat përkatëse, gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- të sigurohet me mjetet e nevojshme për punimet në lartësi;
- të identifikojë ndarjen e mbetjeve, sipas llojit.
- të shpjegojë mënyrën e transportimit të mbeturinave sipas llojit të ndarjes në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi .

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e punonjësit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi, listojnë llojet e hekurave në elementet konstruktivë si dhe të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

	- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si: përshkrimi e veçorive të profesionit ndihmës në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi, listimi llojeve të hekurave në elementet konstruktivë, betonet dhe kallëpet, si dhe të përshkrimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2.Moduli “Punime parapërgatitore në hekurkthim, karpenteri dhe betonim”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME PARAPËRGATITORE NË HEKURKTHIM, KARPENTERI DHE BETONIM	MK-02-398-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në parapërgatitjen e shufrave të hekurit, ndihmojnë në parapërgatitjen për elementet e kallëpeve si dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e materialit mbushës dhe lidhës për përgatitjen e betonit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e shufrave të hekurit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të ndihmojë në përzgjedhjen e shufrave të hekurit ; - të dallojë llojet e hekurave, sipas diametrit të tyre; - të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave të punës, mjetet e nevojshme matëse, shënuese dhe prerëse; - të ndihmojë në grumbullimin e shufrave të hekurit sipas funksionit; - të shtrojë dhe drejtojë shufrat e hekurit në çdo m/l; - të realizojë matje dhe shënime të sakta për përgatitjen e shufrave të hekurit; - të ndihmojë në prerjen e shufrave të hekurit sipas skicës; - të pastrojë armaturë e hekurit nga ndryshku; - të ndihmojë në përgatitjen e stafave sipas skicës; - të zbatojë teknikat e duhura për kthimin e hekurit; - të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vlersim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e materialit mbushës dhe lidhës për përgatitjen e betonit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të përshkruajë vetitë kryesore të materialeve përbërës të betonit;
- të përzgjedhë llojet e materialeve mbushës;
- të përzgjedhë llojet e materialeve lidhëse;
- të ndihmojë në përzgjedhjen drejt të veglave të punës;
- të ndihmojë në vënjen e betonjerës për punë për përgatitjen e betonit ;
- të ndihmojë parapërgatitjen e kubikëve për provat laboratorike;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vlersim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e kallëpeve për elemente betonarme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhi veglat, makineritë, instrumentet, mjetet sipas procesit të punës për punime kallëpesh për elemente betonarme;
- të përzgjedhi llojet e kallëpeve;
- të përzgjedhi bazën materiale sipas procesit të punës për punime kallëpesh për elemente betonarme;
- të ndihmojë në kontrollin dhe sigurimin gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të ndihmojë në sigurimit ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të ndihmojë në matjet për kuotat e shënuara sipas fletës së projektit për punime kallëpesh për elemente betonarme;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në

	mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t`u jepen detyra të ndihmojnë në procesin e parapërgatitjes së shufrave të hekurit, në parapërgatitjen e materialit mbushës dhe lidhës për përgatitjen e betonit si dhe ndihmojnë në procesin parapërgatitor për ndërtimin e kallëpeve. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul me punime ndihmëse në: parapërgatitjen e shufrave të hekurit, parapërgatitjen e materialit mbushës dhe lidhës për betonin dhe parapërgatitjen e karpentierisë. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Punime ndihmëse në hekurkthim dhe betonim”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË HEKURKTHIM DHE BETONIM	MK-02-399-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në organizimin e punës në hekurkthim dhe betonim, të ndihmojnë në punimet e hekurit, të ndihmojnë në montimin e shufrave të hekurit si dhe të ndihmojnë në punimet e betonimit	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës në hekurkthim dhe betonim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të marrë detyrën e dhënë; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të përdorë korrekt terminologjinë profesionale; – të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; – të rendisë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për hekurkthim dhe betonim; – të ndihmojë në kontrollin e veglave dhe instrumentet e nevojshme para përdorimit të tyre; – të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së elementeve të skelës; – të ndihmojë në koordinimin e punës me kolegë duke raportuar tek eprori sipas hierarkisë; – të pastrojë vendin e punës para punimeve; – të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës; Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vlersim me listë kontrolli RN 2 Kursanti ndihmon në punimet e hekurit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të lexojë skica të thjeshta me fragmente punimesh hekuri;	

- të dallojë mënyrën e lidhjes të shufrave të hekurit;
- të ndihmojë në realizimin e matjeve dhe shënimeve të sakta në shufrat e hekurit;
- të ndihmojë në realizimin e prerjes së hekurit, sipas përmasave të dhëna në skica;
- të ndihmojë në drejtimin e hekurit sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në përgatitjen stafave me përmasat e skicës së dhënë;
- të ndihmojë në kthimin e shufrave të hekurit sipas skicës së dhënë;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në montimin e shufrave të hekurit në kallëp.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në leximin e skicave me shufrat e hekurit të elementeve konstruktive beton arme (pllaka, trarë, shtylla, ndërkatë, sheshpushime dhe shkallë etj);
- të ndihmojë në montimin skelerisë duke respektuar radhën e punës;
- të ndihmojë në caktimin e shtresës mbrojtëse sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në montimit të shufrave të hekurit në kallëpet e përgatitura nga karpentieri ;
- të ndihmojë në montimin e shufrave të hekurit sipas pozicionit dhe largësive ndërmjet tyre në kallëp;
- të ndihmojë në vendosjen e stafave sipas pozicionit dhe largësive ndërmjet tyre;
- të ndihmojë në lidhjen e shufrave të hekurit me stafat me tel bari;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ndihmon në punimet e betonimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të lagë me ujë kallëpet para betonimit;
- të ndihmojë në përgatitjen e betonit sipas markës së dhënë;
- të ndihmojë në hedhjen e betonit në kallëpet ku janë montuar shufrat e hekurit në elementet konstruktive beton arme (pllaka, trarë, shtylla, ndërkatë, sheshpushime dhe shkallë etj)duke ruajtur distancat ndërmjet hekurave;
- të ndihmojë në kontrollin e shtresën mbrojtëse gjatë betonimit;
- të ndihmojë në ngjeshjen e betonit me vibrator në gjithë vëllimin e tij;
- të trajtojë strukturat betonarme me ujë duke zbatuar afatin e caktuar;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime hekurkthimi dhe betonimi.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t`u jepen detyra të ndihmojnë në organizimin e punës në hekurkthim dhe betonim, të ndihmojnë në punimet e hekurit, të ndihmojnë në montimin e shufrave të hekurit si dhe të ndihmojnë në punimet e betonimit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul për punime ndihmëse në: organizimin e punës në hekurkthim dhe betonim, në punime hekuri, në montimin e shufrave të hekurit dhe në punimet e betonimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për hekurkthim dhe betonim.
-

-
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punime ndihmëse në karpentieri”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË KARPENTIERI	MK-02-400-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët në organizimin e punës në karpentieri në punimet e kallëpeve për elemente betonarme(plint, shtylla, mure) b/a, në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a. si dhe në punimet e kallëpeve për shkallë b/a	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës në karpentieri Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të marrë detyrën e dhënë; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; – të ndihmojë në riparimin ose përforcimin e sipërfaqes së kallëpit në rast dëmtimesh të vogla. – të ndihmojë në planifikimin e bazës materiale, mjeteve, instrumenteve dhe paisjeve të punës sipas proceseve të punës; – të ndihmojë në vendosjen me rregull të bazës materiale, mjeteve, instrumenteve dhe paisjeve të punës – të ndihmojë në përcaktimin e radhës së kryerjes së punimeve. – të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës; Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (plint, shtylla, mure) b/a. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të përzgjedhë siç duhet materialet, veglat dhe pajisjet e punës; – të interpretojë planet e konstruksionit të kallëpeve për plint, shtylla, mure; – të ndihmojë në kontrollin e kuotave, akseve, përmasave sipas fletës së projektit të plintit, shtyllave, mureve.	

- të ndihmojë në përgatitjen e materialit të nevojshëm për formimin e kallëpeve;
- të ndihmojë të presë dhe ndërtojë kallëpet;
- të ndihmojë në zbatimin e teknikës së lidhjes së dërrasave dhe të elementeve të tjerë për formimin e kallëpeve për plint, shtylla, mure;
- të ndihmojë në përforcimin e kallëpeve;
- të ndihmojë në montimin dhe centrimin e kallëpeve për plint, shtylla, mure;
- të pastrojë, sistemojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas kryerjes së punimeve
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë planet e konstruksionit të kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a;
- të ndihmojë në zbatimin e teknikës së lidhjeve të dërrasave dhe të elementëve të tjerë për formimin e kallëpeve për trarë e pllaka b/a;
- të ndihmojë në prerjen dhe ndërtimin e kallëpeve;
- të ndihmojë në kontrollin, matjen dhe shënimin e kuotës së fundit të trarit, kuotës së fillimit dhe mbarimit të ndërkatit dhe gjerësinë e trarit prej betoni të armuar të lidhur me pllakën ;
- të ndihmojë në përdorimin drejt të materialit për lidhje të kallëpeve;
- të ndihmojë në montimin e skelave mbajtëse duke kontrolluar nivelimin me mastar-nivelë.
- të ndihmojë në montimin dhe centrimin e kallëpeve për trarë e pllaka b/a;
- të ndihmojë në përforcimin e kallëpeve;
- të ndihmojë në montimin e faqeve anësore (fjankot) të mbështetura në skelat mbajtëse (kryqet) duke kontrolluar vertikalisht me mastar-nivelë.
- të ndihmojë në vendosjen e skelave mbajtëse (kryqet) të pllakës dhe t'i kontraventojnë ato në dy drejtimet duke kontrolluar nivelimin e tyre me mastar-nivelë.
- të ndihmojë në montimin e binarëve të dyshemesë së pllakës me skelat mbajtëse (kryqet) duke kontrolluar kuotën dhe nivelimin e tyre me mastar-nivelë.
- të pastrojë, sistemojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas kryerjes së punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli

RN 4 Kursanti ndihmon në punimet e kallëpeve për shkallë b/a

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në zbatimin e teknikës së lidhjeve të derrasave dhe të elementeve të tjerë për formimin e kallëpeve për shkallë b/a;
- të ndihmojë në përgatitjen e materialit të nevojshëm për formimin e kallëpeve;
- të ndihmojë në kontrollin, matjen dhe shënimin e kuotës së përfunduar të dy ndërkateve në faqen e murit të kafazit të shkallës me mjete shënuese, matëse e niveluese sipas fletës së projektit.
- të ndihmojë në kontrollin e kuotes e ndërkatis.
- të ndihmojë në montimin e skelave mbajtëse (kryqet)
- të ndihmojë në prerjen dhe ndërtimin e kallëpeve;
- të ndihmojë në matjet, shënimet e derrasave për kallepet
- të ndihmojë në prerjen e derrasave për kallepet.
- të ndihmojë në montimin e derrasave sipas formes së kallepeve.
- të ndihmojë në forcimin e kallepeve të ndryshme.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.
- të ndihmojë të pastrojë, sistemojë dhe mirëmbajë mjetet e punës pas kryerjes punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të kantjereve të ndërtimit ku kryhen punime karpentierie për skeletbetonarme.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për ndërtimin e kallëpeve të shtyllave, trarëve, pllakave b/a dhe shkallëve b/a . Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë, në organizimin e punës në karpentieri në punimet e kallëpeve për elemente betonarme(plint, shtylla, mure) b/a, në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a në punimet e kallëpeve për shkallë b/a .
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, në organizimin e punës në karpentieri në punimet e kallëpeve për elemente betonarme(plint, shtylla, mure) b/a, në punimet e kallëpeve për elemente betonarme (trarë, pllakë) b/a në punimet e kallëpeve për shkallë b/a .
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise pune për kryerjen e punimeve te karpentierise per skelet betonarme. - Komplete i veglave dhe paisjeve për kryerjen e punimeve te karpientierise per b/a. - Materiale te nevojshme per reakizimin e punimeve te karpentierise per b/a. Standarde perkates.
---	---

5. Moduli “Punime dizarmimi në elementet konstruktiv”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME DIZARMIMI NË ELEMENTET KONSTRUKTIV	MK-02-401-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantet ne organizimin e punës në dizarmimin e elementeve konstruktive, në dizarmimin e elementëve konstruktivë, në riparimet e mundshme për elementët b/a pas dizarmimit.	
Kohëzgjatja e modulit	21 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon ne organizimin e punës në dizarmimin e elementeve konstruktive. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të përshkruajë hapat për trajtimin pas dizarmimi të strukturave prej betoni të armuar; – të përgatisë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për procesin e disarmimit sipas udhëzimeve të instruktorit; – të zbatojë masat e sigurisë gjatë të zonës së punës dhe gjatë heqjes së elementëve; – të ndihmojë në largimin dhe sistemimin e materialeve të çmontuara në vendet e caktuara; – të mbajë pastërti dhe para dhe pas disarmimit; organizimit – të punojë në grup dhe të ndjekë udhëzimet e instruktorit në mënyrë të saktë dhe efektive; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim. - Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në dizarmimin e elementëve konstruktivë . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përgatisë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për procesin e dizarmimit (levë, çekiç gome, çelësa, vegla dore) ; - të ndihmojë ne inspektimin e kallëpeve para dizarmimit ; - të ndihmojë në heqjen e elementeve duke përdorur teknikat e duhura për shmangien e dëmtimeve të betonit ose kallëpeve;	

- të ndihmojë në transportimin dhe sistemimin e elementeve e kallëpeve në vendin e caktuar pas dizarmimit;
- të punojë në ekip, duke bashkëpunuar me të tjerë dhe duke ndjekur me përpikëri instruksionet;
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në riparimet e mundshme për elementët b/a pas dizarmimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në evidentimin e dëmtimeve të thjeshta në elementët e betonit pas dizarmimit.
- të përgatisë mjetet e thjeshta për riparime
- të pastrojë zonën e dëmtuar.
- të ndihmojë në riparimin e dëmtimeve të vogla,
- të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të kantjereve të ndërtimit ku kryhen punime karpentierie për skeletbetonarme.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për dizarmimin e kallëpeve të strukturave b/a . Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë, në organizimin e punës në dizarmimin e elementeve konstruktive, në dizarmimin e elementëve në riparimet e mundshme për elementët b/a pas dizarmimit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul,
- në organizimin e punës në dizarmimin e elementeve konstruktive, në dizarmimin e elementëve në riparimet e mundshme për elementët b/a pas dizarmimit
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës për dizarmimin e elementëve konstruktivë dhe riparimin e defekteve.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për dizarmimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e elementëve konstruktivë.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
